

VENDIM
Nr. 189, datë 2.4.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.27, DATË 11.1.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË FEMRAVE NGA GRUPET
E VEÇANTA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta...” zëvendësohet me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...” dhe emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.
2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë femrat punëkërkuese nga grupet e veçanta, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Zyra përkatese e punësimit financon:

a) punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatese;

b) punëmarrësin e përfshirë sipas këtij programi, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe në muajt e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.”.

3. Në pikën 3 hiqen fjalët “... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...”.

4. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”.

5. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjat “a” dhe “d” pas fjalës “... juridik ...” shtohen “...dhe fizik...”.

b) Pas nënndarjes “v” të shkronjës “dh” shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”.

6. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”.

7. Në pikën 10, pas fjalës “... organizimit ...” shtohen “..., vlerësimit të projekteve...”.

8. Në paragrafin e dytë të pikës 15 hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoriatin rajonal/vendor të punës...”.

9. Në fund të pikës 16 hiqen fjalët “... dhe vlerësimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës ...”.

10. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama